



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:102891

Datë: 22.04.2022

Numri i dokumentit: 02948597

P. nr.259/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Ilirjana Hoti, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.B. nga fshati R., Komuna Gjakovë, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbime në vazhdimësi nga neni 314 par.6-1e lidhur me nenin 77 të KPRK-ës. sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore -DP në Gjakovë PP/II.nr.685/2021 të datës 21.05.2021, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më datë 20.04.2022 në prani të Prokurorit të shtetit Kastriot Memaj , përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarës A.M. të akuzuarit N.B., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari **N.B.**, nga fsh. R. K Gjakovë, tani me banin në B. të P., ne shtëpinë e dhëndrit A.A. ,Rr...,i lindur me..., i biri i H. dhe i nënës V., e gjinisë B. , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me numër personal...

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

-nga data e pavërtetuar e gjerë me datë 15.12.2020 e në vazhdimësi , në shtëpinë e tij që gjendet në fsh. R. K. Gjakovë, me qëllim që vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, në kundërshtim me nenin 61 të Ligjit për Energjinë Elektrike të Kosovës me nr.05 L-085, në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike, ashtu që është ç kyçur nga AMR-ja dhe është lidhur direkt në rrjetin elektrik duke u furnizuar kështu pa matje, me çka me këtë veprim energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç ‘rast të dëmtuarës K.- Distrikti në Gjakovë, i ka shkaktuar dëm në shumën e përgjithshme rreth 550.00 €.

-me çka ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve në vazhdimësi nga neni 314 par.6 lidhur me par.1e lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 39, 46, 47, 48, 49,69 ,70, neni 314 par.6-1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton :

DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **5 (pesë) muaj** , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

I demtuari K.-distri në Gjakovë për realizimin e kërkeses pasruore juridike udhezohet ne kontest civil .

Detyrohet i akuzuara që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20,00 €**, në afat prej **15 ditëve** pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.685/2021 të datës 21.05.2021 ka akuzuar të akuzuarin N.B. nga fshati R., Komuna Gjakovë ,për shkak të veprës penale vjedhje e shërbime në vazhdimësi nga neni 314 par.6-1 të KPRK-ës.

Në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë 14.10.2021, prokurori i shtetit Deshire Jusaj lexoj aktakuzën PP/II.nr.685/2021 të datës 21.05.2021, me ç ‘rast deklaroj se tek dispozitivi i aktakuzës pas datës 15.12.2020 në rreshtin e parë duhet të jetë “ e në vazhdimësi “ , po ashtu edhe tek kualifikimi i veprës penale duhet të jetë vepra penale nga neni 314 par.6 -1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar.

Gjykata konstaton se me aktvendimin P.nr. 259/21 të dt. 4.11.2021, ka pezulluar mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor me qene se i akuzuara N.B. , nuk ka marr pjesë ne seancat e caktuar, ku nga st. Policor ne Gjakovë ,sipas njoftimit me nr. të ref. 04/108-GJ-S-247/21 të datës 24.11.2021 telefonit me nr.tel... ka njoftuar gjykatën se i njëjti nuk është gjetur në shtëpinë e tij , kanë kontaktuar me disa fqinjë të asaj lagje , ku nga ata janë njoftuar se kjo familje është shpërngulur në Pejë tek motra e tyre në afërsi të stacionit të autobusëve dhe për të akuzuarin gjykata ka lëshuar urdhër arrest P.nr. 259/21.

I akuzuari N.B. me datën 20.04.2022 është shoqëruar nga st. policor ne Gjakovë sipas urdhëratësit të lëshuar nga ana e kësaj gjykate P.nr. 259/21 te dt. 24.11.2021, gjykata te njëjtin e ka proceduar dhe ka tërhequr e urdhër arrestin.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt. 20.04.2022 , përfaqësuesi i PTH-DP, në Gjakovë Prokurori Kastriot Memaj , lexon aktakuzën PP/II nr. 685/21 të dt.21.05.2021, me ç ‘rast prokurori deklaroi mbetet ne tërësi pranë aktakuzës dhe me rastin e leximit te aktakuzës beje edhe përmirësimin e shumes së demit te shkaktuar ku tani e tutje do te jete shuma prej 550 euro dhe atë sipas deklarimit te vete perf. se palës se dëmtuar nga seanca fillestare. Në fjalën përfundimtare Prokurori i shtetit Kastriot Memaj deklaroi i akuzuari N.B. gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor është deklaruar fajtor për veprën penale me te cilën akuzohet , pra me vet pranimin e fajësisë është vërtetuar ne tersi gjendja faktike e përshtuar si ne dispozitivin e aktakuzës .Gjykatës i propozoi qe te akuzuarin ta shpallë fajtor dhe te dënojë sipas ligjit duke i vlerësuar te gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese konform nenit 69 dhe 70 te KPRK-ës, po ashtu i njëjti te obligohet ne pagesën e shpenzimeve procedurale .

I akuzuari N.B. ,gjatë shqyrtimit gjyqësor lidhur me fajësinë ,thekson se në këtë fazë te procedurës e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimin te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion ne fjalën e tij përfundimtare deklaroi se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e përkryer për shkak te gjendjes se dobët ekonomike me qene se jam i pa punë , premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet dhe në te ardhmen do të jem me i kujdesshëm pasi qe tani me nuk jam duke banuar ne shtëpinë për te cilën pretendohet se është kryer vepra penale , andaj i propozoi gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , premtimi se ne te ardhmen nuk do te përsërisë vepra penale te natyrës se njëjtë apo te ngjashme ,kërkim falje nga e dëmtuara për demin e shkaktuar , gjendjen e dobët ekonomike, si dhe faktin se me parë nuk ka ra ndeshë me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë.

Perf. e autorizuar e të dëmtuarës A.M., në fjalën përfundimtarë deklaroi se e mbështet ne tërësi fjalën përfundimtare te prokurorit te shtetit , ndërsa mbetet ne tërësi pranë kërkesës për kompensimin e demit te precizuar gjatë shqyrtimit fillestar .

Pasi gjykata ka fituar bindjen se e akuzuara e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprat penale që i vihen në barrë dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza ,ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 të KPPK-së, dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin dhe llojet e tij, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara nga neni 69 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Rrethana rënduese gjykata e konsideron faktin se e akuzuari ka kryer veprën penale e në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitiv e këtij aktgjykimi , ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se i njëjti është i moshës relativisht të re , sjelljen e tij korrekte në seancë , pranimin e fajësisë, kërkim falja publike nga e dëmtuara , premtimi se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme, gjendjen e dobët ekonomike , i papunë , i pa strehë kështu që duke mos gjetur rrethana posaçërisht rënduese gjykata ka zbatuar dispozitat e zbutjes se dënimit bazuar në nenin 70 të KPRK-së dhe të akuzuarit ia ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje e plotë se ky dënim është në harmoni me peshën e veprave penale ,shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit , personalitetin e të akuzuarit dhe se gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj te akuzuarit do te arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 dhe 47 të KPRK-ës. dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarës nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e saj ,do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale , ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata, duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, ka vendosur që të dëmtuarën, për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta udhëzojë në kontest të rregullt juridiko civil, ngase, të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, të kërkesës pasurore juridike

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale në shumë prej 20.00 € në emër të paushallit gjyqësor, është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.259/21 më datë 20.04.2022

Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci

Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15ditësh**, nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ne kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate..